



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, maj 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit (KGJ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 3,768,965€, si rezultat i ekzekutimit të pagesave bazuar në vendime gjyqësore/përmbarrimore;
- B2 Blerjet e pasurisë në vlerë 1,761,172€ nuk ishin regjistruar në sistemin e SIMFK-së dhe e-pasurisë, duke rezultuar në nënvlerësim të pasurisë në raportin vjetor financiar për këtë shumë;
- A1 Detyrimet kontigjente të shpalosura në RVF ishin mbivlerësuar për 152,231€, si pasojë e përfshirjes së pretendimeve të dyfishuara;
- B3 Obligimet e papaguara të shpalosura në RVF ishin mbivlerësuar për 13,719€, për shkak të mos largimit nga regjistri i faturave tashmë të paguara.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjilanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B4 Në tre raste të obligimeve në vlerë totale prej 5,410€, ishin evidentuar vonesa në pagesë që varionin nga 5 deri 120 ditë pas afatit të përcaktuar ligjor;
- B5 Komuna nuk kishte zbatuar procedurat e prokurimit, me rastin e angazhimit të 95 punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta;
- B6 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme, në përputhje me kërkesat ligjore;
- C1 Në një rast të pagesës në vlerë 7,693€, ishin bërë ndryshime në ndarjet buxhetore të projekteve kapitale pa miratim nga Kuvendi Komunal.
- A2 Komuna kishte iniciuar procedura të prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjilanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjilanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjilanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjilanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar janë: keqklasifikimii shpenzimeve në kategoritë ekonomike, nënvlerësim i pasurive, mbivlerësim i detyrimeve kontigjente dhe obligimeve të pa paguara. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte mangësi tek, iniciimi i procedurave të prokurimit verifikimi i pronave për tatimin në pronë, kontraktimit të punonjësve me shërbimeve të veçanta, ridestinimi i projekteve kapitale si dhe vonesa në pagesën e faturave.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollin e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre dy janë rekomandime të reja, një rekomandim pjesërisht i përsëritur dhe 10 rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keq klasifikim i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga "Rezerva" me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtares Kryesore Administrative. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore, përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, plani kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë.

Komuna nuk kishte planifikuar fonde rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore. Si pasojë, në 21 pagesa në vlerë totale prej 3,768,965€, obligimet e krijuara nga këto vendime janë mbuluar nga kategori të tjera buxhetore, duke rezultuar në klasifikim të shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate si në vijim:

- Vendime gjyqësore në vlerë 2,452,435€, janë ekzekutuar për obligime që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta, prej të cilave 1,597,845€ ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale, 723,145€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe 131,445€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve;
- Gjithashtu, vendime gjyqësore në vlerë 1,316,530€ janë ekzekutuar

në kategori ekonomike jo adekuate, prej të cilave 722,856€ nga investimet kapitale për shpenzime që i takojnë mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 593,674€ për shpenzime të natyrës kapitale ishin ekzekutuar nga kategori të tjera, përkatësisht 394,674€ nga mallrat dhe shërbimet dhe 199,000€ nga subvencionet dhe transferet.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së ndarjes së fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, dobësive në kontrollet e brendshme gjatë planifikimit buxhetor, si dhe vonesave në pagesën me kohë të obligimeve.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin ose nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke rezultuar në prezantim jo të saktë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlerësim i pasurive kapitale dhe jo kapitale në regjistrat e pasurive

Gjetja

Rregullorja Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Pasuritë e prezantuara në raportin vjetor financiar ishin të nënvlerësuara për 1,761,172€⁵, për shkak të mosregjistrimit të pasurive si në vijim:

- Në nëntë raste investime në vijim të paguara gjatë vitit 2025 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe fushave sportive, në vlerë 1,756,113€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të SIMFK-së si pasuri në vijim; si dhe
- Në katër raste pasuri jokapitale të teknologjisë informative dhe pajisje të tjera / mobilje të blera gjatë vitit 2025, në vlerë 5,059€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Kjo ka ndodhur për shkak të mangësive në zbatimin e kontrolleve të brendshme për regjistrimin me kohë dhe të plotë të pasurive, si dhe për shkak të moskoordinimit adekuat ndërmjet zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e pasurisë dhe atyre të financave.

Ndikimi

Mos regjistrimi i investimeve në vijim dhe i pasurive jokapitale ndikon që vlera e pasurive të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet e brendshme për menaxhimin e pasurisë, duke siguruar që të gjitha investimet në vijim dhe pasuritë e blera të identifikohen, regjistrohen dhe raportohen me kohë në regjistrat përkatës (SIMFK dhe e-Pasuria). Po ashtu, duhet të përmirësohet koordinimi ndërmjet njësive përgjegjëse për financa dhe menaxhimin e

pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente

Gjetja Rregullorja e MF Nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, Neni 6, përcakton se: “Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”. Ndërsa neni 18 i kësaj rregullore përcakton se organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në janë të obliguara të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin financiar vjetor ishin mbivlerësuar për 152,231€, pasi komuna ka përfshirë në regjistrin e detyrimeve kontigjente 21 pretendime të dyfishuara duke rezultuar me prezantimin e të njëjtave pretendime dy herë .

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në kuadër të zyrës ligjore, për përditësimin sistematik të regjistrit të detyrimeve kontigjente, si dhe për shkak të mungesës së koordinimit me zyrën e financave para përgatitjes së raportit financiar vjetor.

Ndikimi Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente ndikon në pasaktësi në raportin vjetor financiar dhe mund të ndikojë në vendimmarrje jo të drejtë nga menaxhmenti. Po ashtu, shfrytëzuesit e raportit vjetor financiar nuk informohen në mënyrë të saktë për gjendjen reale të detyrimeve kontigjente të komunës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme dhe koordinimin ndërmjet zyrës ligjore dhe zyrës së financave, në mënyrë që regjistri i detyrimeve kontigjente të përditësohet në mënyrë të rregullt dhe të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara në raportin vjetor financiar

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, Neni 6 parasheh se: “Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Obligimet e papaguara nuk janë prezantuar saktë në raportin vjetor financiar, pasi që tri⁶ fatura në vlerë 13,719€ të cilat ishin paguar gjatë viti 2025, janë shpalosur gabimisht si obligime të papaguara.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo të mjaftueshme në menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara nga zyrtarët përgjegjës financiar.

Ndikimi Prezantimi i gabuar i obligimeve të papaguara ndikon në mbivlerësim të

tyre në raportin vjetor financiar dhe mund të ndikojë në vendimmarrje jo të drejtë nga menaxhmenti. Kjo ndikon në saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar dhe mund të çojë në vendimmarrje të gabuar nga menaxhmenti dhe përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme mbi menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara. Zyrtarët përgjegjës financiarë duhet të verifikojnë rregullisht të dhënat dhe të sigurojnë që vetëm obligimet ekzistuese të raportohen në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B4 - Vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve

Gjetja Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), nenit 39.1 parasheh që: “ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata buxhetore përkatëse”.

Në tri⁷ raste, në vlerë totale prej 5,410€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor të përcaktuar. Vonesat në pagesë varionin nga 5 deri në 120 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo kishte ndodhur kryesisht si rezultat i mungesës së mjeteve financiare për shkak të pagesave të pa planifikuara të realizuara përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore.

Ndikimi Vonesat në pagesën e faturave rrisin rrezikun e krijimit të kostove shtesë për komunën, përfshirë shpenzime nga procedurat gjyqësore dhe përmbartimore.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë planifikim dhe menaxhim më efektiv të mjeteve financiare në mënyrë që të sigurohet që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja Sipas Ligjit për zyrtarët publik nr. 08/L-197, neni 101 thekson se “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik”. Më tutje, sipas nenit 57, procedura e prokurimit për shërbime të veçanta, aplikohet për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilët nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik.

Në 95 raste, Komuna nuk kishte aplikuar procedurat e prokurimit me rastin e angazhimit punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta gjatë vitit 2025. Për këta punonjës nuk ishte aplikuar as procedurë e rekrutimit me kriterë përzgjedhëse, ndonëse ata ishin angazhuar për kryerjen e detyrave që i përkasin pozitave të rregullta të punës. Pagesat për këta punonjës ishin realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve⁸.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve efektive të brendshme dhe mbikëqyrjes nga menaxhmenti lidhur me zbatimin e procedurave ligjore për angazhimin e stafit.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit me rastin e angazhimit të stafit mund të ndikojë në mungesë të transparencës dhe konkurrencës në

procesin e përzgjedhjes, si dhe të rrisë rrezikun për angazhimin e personave që mund të mos kenë kualifikimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të caktuara.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e angazhimit të stafit për shërbime të veçanta, të respektohen kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës, përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në mënyrë që të sigurohet transparencë, konkurrencë dhe përzgjedhje e duhur e stafit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 15, paragrafi 2, parasheh se: "Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat".

Komuna gjatë vitit 2025 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të objekteve të regjistruara brenda territorit të Komunës, mirëpo brenda vitit kishte bërë inspektimin e vetëm 6.5% të objekteve të përgjithshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit dhe kapaciteteve të pamjaftueshme për realizimin e aktiviteteve inspektuese, si dhe mungesës së një plani efektiv për përmbushjen e kërkesës ligjore përkatëse.

Ndikimi Mos inspektimi i objekteve rezulton me informata jo të plota të pronave aktuale dhe me ndikim në vlerësim jo të drejtë dhe të saktë të ngarkesave për tatimin në pronë, respektivisht pranime më të ulëta të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë planifikim më të mirë dhe forcim të kapaciteteve për aktivitetet inspektuese, në mënyrë që të përmbushet kërkesa ligjore për verifikimin e së paku 20% të objekteve brenda vitit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja Ligji Nr. 08-L-332 për ndarjet buxhetore për vitin 2025, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal"

Gjatë ekzaminimit të pagesave të projekteve kapitale kemi identifikuar një pagesë në vlerë prej 7,693€, për të cilën fondet ishin marrë nga projekte të tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore ishin bërë pa marrë paraprakisht aprovimint e Kuvendit Komunal për ridestinim të fondeve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme gjatë procesit të rialokimit të fondeve buxhetore.

Ndikimi Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrjen lidhur me shfrytëzimin e fondeve publike. Po ashtu, mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese, duke rrezikuar financimin e mjaftueshëm të tyre.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të merret paraprakisht aprovimi i Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 19.17 ndër të tjera përcakton se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv, i cili në mënyrë të detyrueshme duhet t'i bashkëngjitet specifikave teknike (gjithashtu në formë elektronike) si pjesë e dosjes së tenderit. Asnjë autoritet kontraktues nuk lejohet të publikojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e detajuar të projektit.

Komuna kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte lidhur kontratë për projektin "Rikonstruimi i rrugëve në Komunën e Gjilanit, Lot 1 deri në Lot 6 - Rrugët Lidhja e Prizerenit, Xheladin Kurbaliu dhe Skifter Arifi" Lot 3 në vlerë 699,426€, pa u hartuar paraprakisht projekti ekzekutiv, por vetëm duke u bazuar në specifikacionet teknike.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga njësitë kërkuese dhe Zyra e Prokurimit lidhur me përgatitjen e projektit të detajuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj në realizim jo efektiv të kontratave për punë si dhe të shkaktojë shpenzime të paparashikuara apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive nga njësitë kërkuese dhe Zyra e Prokurimit, në mënyrë që, para inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, të sigurohet hartimi i projekteve ekzekutive në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat e projektit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2025 ishin në vlerë prej 4,964,879€, apo 98.5% e të hyrave të planifikuara. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike.

Çështja B7 - Mangësi në raportimin për shfrytëzimin e pronave komunale

Gjetja

Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 22, paragrafi 2, specifikon se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore, ti paraqet Kuvendit Komunal edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”.

Në raportimet e Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal gjatë vitit 2025, nuk ishin përfshirë informata lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Po ashtu, Kuvendi Komunal nuk ishte njoftuar as për rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratave, përfshirë mos pagesën e qirasë, të cilat janë paraqitur në këtë raport.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një sistemi efektiv për mbikëqyrjen dhe montiromin e kontratave për pronat e dhëna në shfrytëzim, si dhe për shkak të mungesës së mekanizmave adekuatë të llogaridhënies dhe raportimit për këto prona.

Ndikimi

Mungesa e raportimit të rregullt ndaj Kuvendit Komunal krijon mospërputhje me kërkesat ligjore dhe mund të ndikojë në transparencën dhe efikasitetin e menaxhimit të pronave komunale, si dhe në realizimin e plotë të të hyrave nga këto prona.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë raportim të rregullt dhe të dokumentuar në Kuvendin Komunal për monitorimin e realizimit të kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim, duke përfshirë edhe masat që duhet të ndërmerren në rast të mosrespektimit të kushteve kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,602,641€, prej tyre ishin shpenzuar 7,178,819€ apo 83% Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e objekteve, rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

Çështja B8 - Mospërdorim i modulit në e-prokurim për menaxhim e kontratave dhe vlerësimin e performances së kontraktuesve

Gjetja Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton se: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualet për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24 të kësaj rregulloreje, menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Në pesë (5)⁹ kontrata në vlerë 19,877,665€, menaxherët e kontratave nuk kishin mbajtur dhe arkivuar dokumentacionin për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme të menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre, për përdorimin e modulit përkatës në sistemin e e-prokurimi.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i të dhënave të menaxhimit të kontratave në sistemin e prokurimit elektronik mund të ndikoj në një menaxhim jo të plotë dhe transparent të kontratave, si dhe mund të kufizojë mundësinë që menaxhmenti të ketë informata të sakta dhe në kohë lidhur me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të përdorin modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës, në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në RFV është 241,670,944€, e pasurive jokatitale është 2,193,513€ dhe e stoqeve 209,476€.

Çështja B9 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja Rregullorja Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 11, përcakton që: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi”.

Në 10 mostra në vlerë 843,184€, pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2014-2023, figurojnë në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat janë në përdorim nga komuna. Për këto projekte nuk ishte realizuar pranimi teknik, dhe si rezultat ato nuk ishin transferuar nga kategoria e investimeve në vijim në pasuri në përdorim dhe nuk ishte filluar kalkulimi i zhvlerësimit të tyre.

Në mungesë të informatave të sakta lidhur me kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit në zhvlerësim, përkatësisht vlerën e mundshme të mbivlerësimit të pasurisë në raportin vjetor financiar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i dobësive në kontrollet e brendshme dhe mungesës së monitorimit efektiv për përfundimin me kohë të pranimit teknik dhe regjistrimin e pasurive.

Ndikimi Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe mos regjistrimi i pasurive në përdorim për pasuritë e përfunduara ndikon në klasifikim dhe raportim jo të saktë të pasurive në raportin vjetor financiar, pasi për këto pasuri nuk llogaritet zhvlerësimi, duke rezultuar në mbivlerësim të mundshëm të vlerës së pasurive.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë realizimin me kohë të pranimit teknik për projektet e përfunduara dhe transferimin e tyre nga investime në vijim në pasuri në përdorim, në mënyrë që të fillojë kalkulimi i zhvlerësimit dhe të sigurohet raportim i saktë i pasurive në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2025 ka shpalosur në RFV llogaritë e arkëtueshme në vlerë 18,101,664€ dhe krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 2,505,285€ (në vitin 2024 ishin 15,596,379€).

Çështja B10 - Dobësitë në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06-L-005, "Komuna, Ministria e Financave dhe organet përkatëse ekzekutive kanë kompetenca dhe autorizime për të mbledhur detyrimet e papaguara tatimore që tejkalojnë shumën prej dhjetë (10) €". Ndërsa sipas nenit 27 të këtij ligji, "Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori". Gjithashtu sipas nenit 2, të kontratave për qiradhënie, qiraja paguhet deri më datën 5, përkatësisht 10 të muajit vijues.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2025 ishin 18,101,664€, krahasuar me vitin 2024, janë rritur për 16%, përkatësisht për 2,505,285€. Rritja është evidentuar kryesisht tek tatimi në pronë dhe tek qiratë.

Në 10 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë prej 1,718,927€, si dhe në 5 (pesë) raste të qirasë së hapësirave publike në vlerë prej 25,135€, komuna nuk kishte ndërmarrë masa ligjore përmes përmbauesve për arkëtimin e këtyre borxheve, edhe pse janë tejkualuar afatet e përcaktuara me kontratë dhe afatet në njoftimet për rikujtimin e borxhit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme, përfshirë edhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore, si dhe mungesës së politikave konkrete nga ana e komunës për mbledhjen e të arkëtueshmeve.

Ndikimi

Mos arkëtimi me kohë i të arkëtueshmeve rezulton me të hyra buxhetore më të ulëta nga fondi i të hyrave vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke kufizuar mundësinë e financimit të projekteve dhe investimeve që mbështeten nga këto fonde.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga debitorët, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore për arkëtimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 **Mos pajtueshmëritë lidhur me deklaratimet në Raportin Vjetor Financiar.**

Gjetja

Në Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të Komunës së Gjilanit kemi identifikuar mos-pajtueshmëri në deklaratime si në vijim:

1. Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme (burimet dhe shfrytëzimi i fondeve) - nuk ishin shpalosur kthimet e depozitave;

2. Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit:

- tek hyrjet e parasë së gatshme - shuma e buxhetit fillestar dhe final për të hyrat tatimore dhe jo-tatimore nuk ishte prezantuar saktë;
- tek daljet e parasë së gatshme- nuk ishin shpalosur kthimet e depozitave (e reflektuar edhe në Shënimin 7);

3. Shpalosjet:

- Neni 21 - Të hyrat vetanake të pashpenzuara nuk ishin shpalosur saktë;
- Neni 18 Detyrimet kontingjente nuk ishin prezantuar saktë (një pjesë e pasaktësive është korrigjuar nga komuna, ndërsa pjesa e mbetur e paadresuar është trajtuar në kuadër të gjetjeve që ndikojnë në opinion).

Veprimi i kërkuar

Komunës i është kërkuar të bëjë korrigjimet e nevojshme në Raportin Vjetor Financiar me qëllim të sigurimit të paraqitjes së saktë dhe të plotë të informacionit financiar.

Rezultati

Komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka korrigjuar mos-pajtueshmëritë e identifikuar, në përputhje me kërkesat rregullatore. Megjithatë, komuna duhet të ketë në vëmendje forcimin e kontroleve të brendshme në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të raporteve financiare, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së çështjeve të ngjashme në të ardhmen. Në rast të përsëritjes, çështja do të trajtohet si gjetje me rekomandim përkatës.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁰	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	37,189,018	41,375,005	39,364,216	39,282,737	34,111,198
Grante Qeveritare - Buxheti	32,150,510	34,186,303	33,006,333	33,773,909	29,531,115
Të bartura nga viti i kaluar	0	2,116,870	1,885,249	1,785,067	1,290,241
Të hyrat vetanake	5,038,508	5,038,508	4,462,697	3,693,617	3,201,622
Donacionet vendore	0	15,839	9,937	25,866	8,855
Donacionet e jashtme	0	17,485	0	4,278	79,365

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 4,185,987€. Kjo rritje është rezultat, i mjeteve shtesë nga granti qeveritar prej 2,035,793€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 2,116,870€ dhe donacioneve 33,324€.

Në vitin 2025 Komuna e Gjilanit ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar, ku edhe në vitin 2024 realizimi ishte 95%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	37,189,018	41,375,005	39,364,216	39,282,737	34,111,198
Pagat dhe mëditjet	19,773,824	21,813,839	21,808,364	21,913,906	18,882,012
Mallrat dhe shërbimet	6,838,311	7,482,934	7,143,059	6,755,847	6,532,677
Komunalitë	675,100	675,100	653,322	677,218	605,132
Subvencionet dhe transferet	1,536,340	2,800,492	2,580,652	1,445,565	1,692,527
Investimet Kapitale	8,365,443	8,602,641	7,178,819	8,490,201	6,398,850

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,040,015€. Kjo rritje ishte bërë me qëllim të mbulimit të obligimeve që kanë rrjedh nga kontrata kolektive.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 644,623€. Kjo rritje ishte nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe donacionet për mbulimin e nevojave të komunës për shpenzime që i takojnë kësaj kategorie. Ndërsa, ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte 95%.
- Buxheti final për komunalitë nuk kishte ndryshime nga buxheti fillestar. Ndërsa, ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte 97%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,264,152€, Kjo rritje ishte nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe donacionet për subvencionimin në bujqësi, kulturë, arsim dhe sport. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 92% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 237,197€. Kjo rritje ishte për financimin e projekteve kapitale që do përmirësojnë infrastrukturën e komunës. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 83%. Arsyet e mos shpenzimit të mjeteve në këtë kategori ishin për shkak se kuvendi komunal nuk kishte arritur që të aprovonte buxhtin brenda afateve kohore.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2025 ishin në vlerë prej 4,964,879€, apo 98.5% e të hyrave të planifikuara. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike. Në këtë shumë nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga Gjykatat në shumën prej 296,507€ të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), e të cilat i alokohen komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	5,038,508	5,038,508	4,964,879	4,365,101	6,663,515
Të hyrat tatimore	2,772,824	2,772,824	2,361,968	1,621,281	3,088,495
Të hyrat jo tatimore	2,265,684	2,265,684	2,591,781	2,742,587	3,259,314
Të hyrat tjera	0	0	11,130	1,233	315,706

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2024 të Komunës së Gjilanit ka rezultuar me 14 rekomandime kryesore. Komuna e Gjilanit kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tre rekomandime janë zbatuar, një rekomandim ishte zbatuar pjesërisht ndërsa 10 rekomandime nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që në kordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se do të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e pasurive që të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës, të bëhet azhurnimi i regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare si dhe të shpalosen saktë në PVF.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet e brendshme për të siguruar se janë ndërmarrë veprime për adresimin e shkaqeve që kanë ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve të pa paguara për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se procedura e prokurimit do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik, dhe kur autoriteti kontaktues nuk i di sasi të indikative me çmim për njësi atëherë nuk duhet të përfshihet në kontratë edhe devijimi +/-30%.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se në Kuvendin Komunal dorëzohen raporte të rregullta gjashtë (6) mujore. Ato duhet të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, si dhe përmbushjen e planeve për dhënie të pronave në shfrytëzim.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në mënyrë që komisioni vlerësues të kryejë vlerësimin e tenderëve brenda afatit 30 ditorë.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestnim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar në tersi, pasi edhe në vitin 2025 ka rezultuar kjo çështje.	Pjesërisht i zbatuar

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit së pari të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për financimin e projekteve. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.	Komuna kishte ndërmarr veprimet për zbatim të rekomandimit, pasi që kjo çështje nuk ka rezultuar në auditimin e vitit 2025.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit	Nuk ka filluar zbatim
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmanget shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.	Rekomandimi ende nuk është zbatuar pasi që çështja e njëjtë ka rezultuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	<p>REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI</p>	
---	---	---

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjiçanit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Alban Hyseni, Kryetar i Komunës
Komuna e Gjiçanit
04.05.2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹², duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Vendim gjyqësor 274,000€, vendim gjyqësor 270,000€, vendim gjyqësor 260,000€, vendim gjyqësor 250,000€, vendim gjyqësor 224,347€, vendim gjyqësor 182,143€, vendim gjyqësor 145,000€, vendim gjyqësor 78,751€, vendime gjyqësore 71,872€, mobile 1,185€, pajisje tjera 990 €, pajisje tjera 984€, pajisje tjera (pompë uji) 900€, libra 1,000€.
- ⁶ Konsulentë dhe Kontraktorë individual 4,000€, Konsulentë dhe Kontraktorë individual 4,000€, Rryma 10,000€.
- ⁷ Pajisje tjera 2,400€, Pajisje tjera 1,810€, Pajisje tjera 1,200€.
- ⁸ Zyrtar Protokolli, Zyrtar i Logjistikes, Zyrtar per Mbrojtje nga Diskrimini, Zyrtar per Informim, Koordinator i Brendshem, Konsulent i Jashtem i Audimit, Zyrtar Ligjor, Asistente Administrative, Zyrtar i Prokurimit, Zyrtar per Kthim dhe Komunitete, Zyrtare Administrative, Zyrtar per Emergjence, Zyrtar i Komunikacionit, Zyrtar per Zhvillim dhe Planifikim, Zyrtar i Arkitektures, Zyrtar i Ndertimtarise, Zyrtar Juridik, Inspektor i Ndertimtarise, Inspektor i Sherbimeve Publike, Inspektor i Ndertimtarise, Inspektor i Sherbimeve Publike, Inspektor i Ambientit, Inspektor i Makinerisë, Teknik i Stomatologjise, Zyrtar per Gjeodezi dhe Kadaster, Zyrtar per Bujqesi, Zyrtare e Hidros, Zyrtar i Tatimit, Zyrtar i Tatimit ne Prone, Zyrtar per Turizem, Asistente ne Zyren e Personelit, Koordinator, Zyrtar Financiar, Juriste, Ekonomiste.
- ⁹ Ndërimi i Projektit te integruar të Bulevardi të qytetit të Gjilanit - Projekti integruar i sheshit, parkingur nëntokesor dhe objektit të administratës 17,988,067€, Rikonstruimi I rrugëve në Komunën e Gjilanit Lot1 deri në Lot 6 - Rruga “Lidhja e Prizerenit”, Xheladin Kurbaliu dhe Skifter Arifi” lot tretë 699,426€, Rrethrotullimi - Nyja Kryesore, Rruga e Prishtinës, Rruga Qarkore 339,252€, Ndërtimi i rrugëve me infrastructure përcjellëse Lagjja Fidanishte II, “ Infrastruktura në P.RR.U. Fidanishtë dytë 291,724€ “Ndërtimi i rrugës Fidanishtë 2” (Infrastruktura në P.RR.U. Fidanishtë 2) - krahu 3 L=500m 559,194€,
- ¹⁰ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹¹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹² Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.